



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILI I MINISTRAVE

### VENDIM

Nr....., datë .....2018

### PËR

### KRITERET DHE MËNYRËN E ZONIMIT TË TERRITORIT TË NJË ZONE TË MBROJTUR MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 e 2 të neni 13 dhe pikës 3 të nenit 47 të ligjit nr. 81, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

### VENDOSI:

#### I. TË PËRGJITHSHME MBI ZONIMIN E TERRITORIT TË ZONËS SË MBROJTUR MJEDISORE (ZMM)

1. Qëllimi i përgjithshëm i sistemit të zonave të mbrojtura është rritja e efektivitetit të ruajtjes in-situ të biodiversitetit, nëpërmjet qasjes e të kuptuarit të rolit të Zonës së Mbrojtur Mjedisore (ZMM) në përmbushjen e angazhimeve kombëtare të konservimit të biodiversitetit, në përputhje me objektivat e menaxhimit të caktuara në dokumentat strategjike të mjedisit dhe biodiversitetit.
2. Sistemi i nënzonimit të territorit të zonës së mbrojtur mjedisore krijohet për të bërë sa më të qarta dhe të sakta rregullat dhe kufizimet për këtë zonë të mbrojtur mjedisore, për të rregulluar/harmonizuar menaxhimin e vlerave të zonës me intensitetin e ndryshëm të aktiviteteve njerëzore, në kuadrin e një standardi të pranuar për nënzonimin e territorit, duke marrë në konsideratë vendndodhjen, karakteristikat tipike të rajoneve biogeografike, si dhe statusin e mbrojtjes së territorit.
3. Sipërfaqja e zonës së mbrojtur mjedisore për kategoritë “Park Kombëtar”, “Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror” dhe “Peizazh i mbrojtur”, ndahet në nënzona, administrimi i të cilave mbështetet në gjendjen, rëndësinë e biodiversitetit, ekosistemeve, habitateve, llojeve floristike e faunistike, peizazhit, të veprimtarive ekonomike, sociale, argëtuese-sportive, historike-kulturore dhe eko-turistike.

4. Për zonat e mbrojtura të kategorive “Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor” dhe “Monument natyror”, nuk do ketë zonim të brëndshëm por vetëm lejim të aktiviteteve të përkohshme turistike me miratim të ministrit nëpërmjet planit të menaxhimit. Me qëllim parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjiksht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të tyre, krijohet një zonë buferike me gjerësi deri në 200 metra nga perimetri jashtëm i zonës së mbrojtur, ku lejohen vetëm aktivitetet konservuese të përshtatshme.
5. Procesi i zonimit është një formë e rregullimit të përdorimit të territorit të zonës së mbrojtur mjedisore (bujqësore, pyjore, kullosore, ujore, lagunore, liqenore, bregdetare, detare, malore, joproduuese, urbane-troje, etj) që përfshin ndarjen në nënzona me status mbrojtjeje të ndryshëm, duke marr parasysh kriteret e Unionit Botëror për Rajtjen e Natyrës (IUCN), përcaktimin e objektivave të menaxhimit të ZMM, rregullimin publik e privat të karakterit dhe intensitetit të përdorimit të tyre, në përputhje me ruajtjen e vlerave ekologjike, të biodiversitetit, peizazhit dhe zhvillimin e qëndrueshëm e të balancuar të territorit dhe të burimeve natyrore.
6. Ndarja në nënzona e territorit të ZMM të konsiderohet si zgjidhje e pranueshme nga komuniteti, privatët, OJF-të mjedisore dhe institucionet shtetërore e kërkimore-shkencore, subjektet ekonomike për ruajtjen e natyrës, të biodiversitetit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, të prodhimeve e veprimtarive tradicionale dhe të turizmit.

## II. OBJEKTIVAT KRYESORE TË ZONIMIT

1. Procesi i zonimit të një sipërfaqejeje të ZMM është kompleks, delikat dhe që kërkon mirëcaktimin e veprimeve, mbështetje shkencore, teknike, materiale dhe integrimin e përvojave më të mira në kushte konkrete të zhvillimeve social-ekonomike, planit të përgjithshëm të planifikimit të territorit, politikave, programeve për ruajtjen e natyrës dhe të përparësive përkatëse rajonale.
2. Në zhvillimin e këtij procesi të merren në konsideratë këto objektiva kryesore:
  - a) të sigurohet mbrojtje për habitatet dhe llojet kritike apo tipike e simbolike, të ekosistemeve, proceset ekologjike si dhe rastet unike gjeomorfologjike nga shqetësimi dhe keqpërdorimi për interesa publike e private;
  - b) të realizohet ndarja e përdorimeve të papajtueshme nga njëri-tjetri dhe të aktiviteteve konfliktuale të njerëzve;
  - c) t’u jepet prioritet përdorimeve apo qëllimeve specifike në nënzona të ndryshme dhe të ruhen zona të përshtatshme për përdorime të veçanta nga njeriu, duke minimizuar dukuritë e këtyre përdorimeve në zonën e mbrojtur;
  - d) të ruhet cilësia peizazhore dhe/ose kulturore e ZMM, duke lejuar një spektër përdorues të qëndrueshëm nga njeriu;
  - e) të ruhen zona të përshtatshme për përdorime të veçanta nga njeriu, duke minimizuar dukuritë e këtyre përdorimeve në ZMM;
  - f) të ruhen disa pjesë të ZMM në gjendjen e tyre natyrore apo gjysëm natyrore, të pa shqetësuar nga njeriu, vetëm për qëllime të hulumtimit shkencor apo edukimit

### III. KRITERET E ZONIMIT TË ZMM

1. Menaxhimi i zonave të mbrojtura mjedisore në mënyrë të efekshme, do të arrihet duke përshtatur modele të administrimit nënzonues si "metoda më e mirë për ZMM në vendin tonë, të cilat janë edhe të banuara, me mjaft llojshmëri veprimatrisht sociale, ekonomike e turistike, etj., dhe, si një mënyrë e sigurimit të mbrojtjes së zonave vitale natyrore dhe arritjen e standarteve të dëshiruara".

2. Në përcaktimin e nënzoneve të ZMM të mbahen parasysh këto kritere:

- a) vlerat biologjike, të peizazhit dhe gjëndja e natyrës së ZMM;
- b) ndjeshmëritë ekologjike, hasja e llojeve dhe habitateve të rralla apo të kërcënuara;
- c) gjëndja e natyralitetit, diversiteti, aftësia për t'u konservuar, paraqitja estetike, arritshmëria dhe qartësia;
- d) vlerat kërkimore-shkencore dhe didaktike;
- e) përmasat, pazëvendësueshmëria, rreziku i dëmtimit dhe faktorët brenda dhe jashtë zonës që ndikojnë në menaxhimin e ZMM;
- f) menaxhimi ekzistues dhe gjëndja e infrastrukturës, intensiteti dhe lloji i përdorimit të saj;
- g) banuesit ekzistues, të drejtat dhe pronësia;
- h) presioni i aktiviteteve njerëzore, shërbimet mbështetëse ekzistuese të biznesit dhe turizmit;
- i) koncepti i përdorimit të qëndrueshëm;
- j) mundësitë për të arritur marrëveshje me përdoruesit dhe komunitetin.

### IV. MËNYRA DHE METODOLOGJIA E ZONIMIT TË SIPËRFAQES SË ZMM

#### IV. 1. Mënyra e zonimit të sipërfaqes së zmm

1. Procesi i nënzonimit të territorit të ZMM të ndjekë hapat e më poshtëme:
  - a) kryerja e një pune paraprake për zgjedhjen/përcaktimin e nënzoneve dhe hedhjen e tyre në harta bazë të territorit;
  - b) mbledhja e informacionit të plotë e të nevojshëm mbi natyrën, biodiversitetin, përdorimin e zonës, nevojat e komunitetit dhe jetesa e tyre;
  - c) hartimi i një liste të faktorëve dëmtues dhe kërcënues për ZMM, nëpërmjet analizës SWOT (strength, weakness, opportunities dhe threats);
  - d) grumbullimi i informacionit nëpërmjet kontaktit me institucionet përkatëse (faza e hulumtimit), studimeve të kryera, literaturës, raporteve zyrtare të publikuara si dhe vëzhgimeve në terren;
  - e) përgatitja e projekt-planit të nënzonimit (përgatitja e hartave digjitale) dhe konsultimi me aktorët e interesuar, komunitetin mbi sakësinë dhe përshtatshmërinë e përmbajtjes së planit të nënzonimit të propozuar;
  - f) shqyrtimi i projekt-planit të nënzonimit me aktorët e interesuar dhe komunitetin;

- g) reflektimi i komenteve në projekt-planin e nënzonimit dhe materialet shpjegues përkatëse;
- h) finalizimi i projekt-planit të nënzonimit dhe paraqitja e zonimit të brendshëm të zonës së mbrojtur mjedisore që do të përcillet në KM për t'u miratuar.

2. Krijimi i inventarit mjedisor të përbëjë hapin e parë drejt njohjes së përbërësve natyrorë, në të cilin përfshihen: ajri, toka, ujërat, klima, flora, fauna, infrastruktura, qendrat e banuara e industriale, tërësia e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia historike, kulturore e shpirtërore si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.

3. Kryerja e analizave të gjendjes aktuale të mjedisit në ZMM, që përbëhet nga një sërë komponentësh studimorë, të kategorizuar në: fizik-topografik, natyror, urban, rural, industrial, etj.,

4. Qasja e analizës së peizazhit të zonës së mbrojtur mjedisore duhet të jetë ekologjike-mjedisore dhe në procesin e zonimit përmblihet si më poshtë:

- a) njohja me funksionet e peizazhit, të cilat janë jo vetëm estetike, por mbi të gjitha jetësore dhe ekonomike.
- b) formulimi i strategjive peizazhistike të cilat, ndërsa rritin cilësinë e ekosistemeve, estetike të hapësirës, garantojnë që funksionet jetësore biologjike e ekonomike të peizazhit të ruhen në funksion të aftësisë vetëpërtëritëse të një territori.
- c) garantimi i shumëllojshmërive biologjike e peizazhistike, përmes bimësisë, biodiversitetit dhe gjeomorfologjisë lokale, me mirëmbajtje të ulët dhe që ndjell peizazhin autokton.
- d) ruajtja e karakteristikave vizuale të hapësirave natyrore e bujqësore, pyjore, kullosore, liqenore, ujore, bregdetare, fushore-malore, urbane dhe rurale me karakter mesdhetar.
- e) rritja e mundësisë së përdorimit të aseteve biologjike e peizazhistike përmes prezantimit të funksioneve që tërheqin njerëzit dhe turistët si përdorues të tyre.
- f) sigurimi i zonave "tampon"/zonave mbrojtëse për uljen e dëmtimeve, ndotjes, shkarkimeve, zhurmës, zjarreve, erës dhe faktorëve të tjerë njerëzor e natyror;
- g) formulimi i rregullave të zhvillimit të tokës, përfshirë ato arkitektonike, të tilla që të mos ndikohen negativisht funksionet e ZMM, të biodiversitetit dhe peizazhit.

5. Në procesin e studimit të zonimit duhet të merren parasysh edhe:

- a) *zonat në rrezik* nga: urbanizimi, transporti, ndotja, erozioni, rrëshqitjet, përmytjet etj.;
- b) *funksionet natyrore të peizazhit*: ekosisteme, habitate, lloje, burime, monumente natyrore, estetik/kulturor, etj.;
- c) *cilësia natyrore*: e dëmtuar ose jo, mosha, ndotja, biodiversiteti në rrezik, funksione të dëmtuara të ekosistemit, etj.;
- d) *madhësia dhe forma e elementeve*;
- e) *struktura*: diversiteti i specieve, forma dhe orientimi, mundësitë për lëvizje, konfigurimi etj.;

- f) *identifikimin e trupave ujor si zonat të ndjeshme*: Liqenet natyrore me ujë të ëmbël, ujërave të tjera të ëmbla, estuareve, lagunave e rezervuareve dhe ujërave detare-bregdetare, të cilat janë eutrofike ose të cilat mund të kthehen në të ardhmen e afërt në të tilla, nëse nuk ndërmerren masa për mbrojtjen e tyre; ujërave të ëmbla nën dhe sipërfaqësore të destinuara për ujë të pijshëm, sanitare, etj;.

6. Përbërës i procesit të nënzhonimit është edhe vëzhgimi në terren, i cili:

- a) të konsiderohet si një metodë që ndihmon dhe ballafaqon një numër të konsiderueshëm analizash të thelluara, në kuadër të hartimit të planit dhe procesit të nënzhonimit;
- b) ka kryesisht si bazë të informacionit studimet shkencore mbi mjedisin, të publikuara nga institucione publike apo shkencore, nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata profesionale dhe joqeveritare të ndryshme, etj;
- c) pason fazën e hulumtimeve të dokumentacionit dhe ka si qëllim të verifikojë nëse njohja e karakteristikave të territorit nëpërmjet literaturës përkon me atë aktuale, si dhe çështje të tjera mjedisore që nuk janë hasur në dokumente dhe literaturë.

7. Në përcaktimin e nënzhonave të territorit të ZMM është e domosdoshme të përgatiten në mënyrë të digjitalizuar, duke përdorur ortofotot e Republikës së Shqipërisë, burime të tjera zyrtare apo dhe studime pjesore në terren:

- a) harta fizike dhe përshkrimi i qartë i kufirit topografik të territorit të ZMM (maja, kurrize, lugina, rrugët dhe të tjera shënja topografike, duke përdorur koordinatat UTM-GPS);
- b) harta e ndarjes administrative;
- c) harta e shpërndarjes së sipërfaqes së ZMM, sipas pjerrësisë dhe lartësisë;
- d) harta e përdorimit të territorit;
- e) harta e mbulesës vegjetative;
- f) harta e habitateve të ZMM, sipas rëndësisë së zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve, llojet dhe habitatet parësore, sipas kodit të shoqëruar me një listë e florës dhe faunës së egër në përbërje të tyre, vëzhgimi i listës së kuqe dhe i statusit të kërcënimit;
- g) harta e objekteve historike, kulturore, shpirtërore dhe ekoturistike;
- h) harta e rrugicave, shtigjet për kalimin e banorëve, vizitorëve, turistëve, rrugët detare të lejuara për kalimin e mjeteve lundruese dhe ato sportive e argëtuese; rrugët e për shtegtimin e bagëtive, burimet ujore etj.

8. Proçesi i nënzhonimit të zonës së mbrojtur mjedisore drejtohet nga ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me specialistë të fushës, institucione lokale ose qendrore, të gjithë aktorët e interesuar dhe organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal ose kombëtar.

9. Ndarja, rregullimi i përdorimit të nënzhonave të administrimit dhe caktimi i kufijve të tyre fizik përcaktohet nëpërmjet një procesi analitik të studimeve të kryera dhe të vlerësimit të shtresave të

hartave të prodhura të digjitalizuar, të cilat bazohen në objektivat kombëtare, rajonale dhe vendore të zhvillimit të rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura.

10. Në secilën nënzonë, administrimi, menaxhimi dhe ruajtja e tyre mbështetet dhe zbaton parime, rregulla e kërkesa të njëjta që saktësohen në ligjin “Për zonat e mbrojtura” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Për çdo nënzonë bëhet përshkrimi dhe një deklaram i qëllimit të menaxhimit të tyre, duke theksuar fokusin e menaxhimit, shkallët e mbrojtjes dhe veprimtaritë prioritare për nënzonën si më poshtë:

- a) veprimtaritë e lejuara (ato aktivitete që nuk kërkojnë miratim për menaxhim individual sa here që ndërmerren);
- b) veprimtaritë e papajtueshme (ato aktivitete të cilat duken qartë që janë të papajtueshme me qëllimet e zonës dhe në përgjithësi nuk do të lejohen në këtë nënzonë);
- c) veprimtaritë që kërkojnë aprovim manaxhues (ato aktivitete të cilat nuk janë qartësisht të papajtueshme me qëllimin e zonës, por që mund të kenë ndikime negative) kërkojnë rast pas rasti dhe një raport të thelluar vlerësimi të ndikimeve në mjedis, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre;
- d) veç këtyre në planin e menaxhimit caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje e lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, të cilat nuk janë përcaktuar në dispozitat e ligjit për zonat e mbrojtura.

11. Në përshkrimin e veprimtarive, sipas nënzonave të administrimit, duket të kihet parasysh dhe statusi i zonës së mbrojtur, si më poshtë:

- a) në “parkun kombëtar”, zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin si dhe përjashtohen veprimtaritë e cilësuar në nenet përkatëse të ligjit për zonat e mbrojtura;
- b) “rezervati natyror i menaxhuar/park natyror”, përfaqëson zona me ndërhyrje aktive të njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore, si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore, ku përjashtohen veprimtaritë e cilësuar në nenet përkatëse të ligjit për zonat e mbrojtura;
- c) “peizazhi i mbrojtur”, përfaqëson territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund të ketë edhe qendra banimi që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria e peshkimi. Menaxhohet për mbrojtjen e vlerave peizazhistike të zonës, diversiteti biologjik, si dhe për çlodhje e argëtim. Në këtë kategori zbatohet shkalla e mbrojtjes në përputhje me objektivin kryesor, sikurse përcaktohen edhe veprimtaritë e ndaluara;

- d) në rastin e “zonat e mbrojtura detare”, zbatohen shkallët e mbrojtjes të specifikuar në nenet përkatëse të kategorive të zonave të mbrojtura dhe që përkojnë me objektivat e mbrojtjes ku janë të ndaluara të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në ligjin për zonat e mbrojtura;
- e) në rastin e “zonës veçanërisht e mbrojtur mjedisore për ruajtjen e habitateve të llojeve”, kërkesat për mbrojtjen e habitateve, të llojeve të kërcënuara dhe endemike, të rrugëve të shtegtimit dhe kushteve të shumimit, kryhen në përputhje me dispozitat e ligjislacionit në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit, të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe atij të zonave të mbrojtura;
- f) në rastin e “zonës veçanërisht të mbrojtur mjedisore si habitat i shpendëve ujorë”, nuk lejohen veprimtaritë e caktuara në nenet përkatëse të ligjit për zonat e mbrojtura;
- g) në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore, pyjet janë të përjashtuar nga klasifikimi si pyje prodhues (neni 46) dhe gjuetia është e ndaluar (neni 51);
- h) në zonat e mbrojtura mjedisore mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e parashikuar në planin e menaxhimit dhe që nuk ndalohet shprehimisht nga ligji për zonat e mbrojtura.

12. Zonimi i brëndshëm i territorit duhet të përmbajë:

- a) nënzonën Qëndrore, që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit, siguron një zonë natyrore të pasqetësuar dhe përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte). Kjo nënzonë ndahet në dy nivele A e B, ku janë caktuar edhe veprimtaritë e ndalura, sipas specifikimeve në nenet përkatëse të ligjit për zonat e mbrojtura;
- b) nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm, që ka funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike, për të cilën përdoret shkalla e dytë e mbrojtjes dhe ku janë të ndaluara veprimtaritë e përcaktuara në ligjin për zonat e mbrojtura;
- c) nënzonën e rekreacionit, që ka funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit. Në këtë nënzonë përdoret shkalla e tretë e mbrojtjes, sipas përcaktimeve parashikuar në ligj dhe janë të ndaluara një numër dhe veprimtarish, gjithashtu të përcaktuara në ligj. Njëherazi në këtë nënzonë lejohet rekreacioni me karakter turistik e çlodhës për qëllim argëtimi dhe që nuk tjetëron sipërfaqen e nënzonës për qëllime të tjera ekonomike, të kërkuara në ligjin për zonat e mbrojtura.
- d) nënzonën e Trashëgimisë dhe Peizazhit Kulturor, që ka funksion ruajtjen parësore e vlerave të trashëgimisë dhe të peizazhit kulturor, që përfshihen brenda territorit të ZMM.

**IV. 2. Proçesi i shënimit dhe hartografimit të nënzoneve**

1. Koncepti i nënzonimit, për një zonë të mbrojtur mjedisore, duhet të paraqitet në dy forma të detyrueshme:

- a) pjesa përshkruese;
- b) pjesa hartografike.

2. Në nënzonat e administrimit, krahas emërimit të plotë, përdoren edhe shkurtimet si më poshtë:

- a) nënzona Qëndrore (ZQ);
- b) nënzona e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm (ZPTQ) ose të ndara:
  - i. nënzona e Përdorimit Tradicional
  - ii. nënzona e Përdorimit të Qëndrueshëm
- c) nënzona e Rekreacionit (ZR);
- d) nënzona Bufrike (ZB);
- e) nënzona e Trashëgimisë dhe Peizazhit Kulturor (ZTPK).

3. Shënimi i nënzonave është krijuar si i tillë që të jetë i pagabueshëm në harta me ngjyra dhe në harta bardhë e zi apo dhe në kopjet bardhë e zi të hartave me ngjyra, duke ndjekur kodin e ngjyrave dhe shënjat grafike, sipas paraqitjes në Tabelën 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

#### IV. 3. Metodologjia dhe zhvillimi i planit për nënzonimin e zonave të mbrojtura mjedisore

1. Të gjithë çështjet që do përfshihen në metodologjinë e punës që duhet të kihet parasysh për nënzonimin e një zone të mbrojtur mjedisore, janë paraqitur në Shtojcën 1, që është pjesë përbërese e këtij vendimi.

#### V. TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**